

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHKOLLA E MAGJISTRATURES  
BORDI I DREJTIMIT**

**MIRATOHET**

**Tirane, me 24.09.2004**

**Kryetari**

**Thimjo KONDI**

**PLANI MESIMOR 2004 - 2005**  
**( Viti i pare)**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi i lendeve</b>	<b>Gjiths ej /ore</b>	<b>Leksion ore/jav e</b>	<b>Seminar ore/jave</b>	<b>Semestri i Provimit</b>	<b>Sem.I-re 16 jave</b>	<b>Sem.II- te 16 jave</b>
1	E Drejta Civile (Pj. I - II ) + rregjistrimi i pasurive te paluajtshme	192	4	2	2	4/2	4/2
2	E Drejta Penale ( Pj.I - II )	192	4	2	2	4/2	4/2
3	Procedura Civile	192	4	2	2	4/2	4/2
4	Procedura Penale	192	4	2	2	4/2	4/2
5	E Drejta Tregtare, falimentimi, konkurenca	112	1	1	2	2/1	2/2
6	E Drejta Kushtetuese	64	2	1	2	1/1	1/1
7	E Drejta Komunitare	64	1	1	2	2	2
8	E Drejta Administrative dhe prokurimet publike	64	1	1	2	1/1	1/1
9	E Drejta Familjare	64	1	1	2	1/1	1/1
10	E Drejta e Punes	32	1	1	1	1/1	-
11	Te Drejtat e Njeriut	32	1	1	1	1/1	-
12	Etika profesionale	32	1	1	1	2	-
13	Shkrimi dhe arsytimi ligjor	32	1	1	1	2	-
14	Menaxhimi i gjykatave dhe rasteve	32	1	1	2	-	1/1
15	E Drejta Nderkombetare Private	32	1	1	1	2	-
16	E Drejta Tatimore, doganore	32	1	1	1	2	-
17	Pronesia Intelektuale	32	1	1	2	-	2
18	Ndermjetesimi, arbitrazhi tregtar	32	1	1	2	-	2
	Shuma e oreve	1424 ore	-	-	-	47 ore ne jave	42 ore ne jave

## RELACION

### MBI PLANIN MESIMOR TE VITIT SHKOLLOR 2004-2005 ( Viti i pare)

Shkolla e Magjistratures e Republikes se Shqiperise eshte nje institucion publik i pavarur i sistemit pasuniversitar, i cili nje nga detyrat kryesore te tij ka trainimin fillestar te gjyqtareve brenda nje programi tre vjecar.

#### Programi trevjecar perfshin:

- **Vitin e pare-** qe eshte me karakter teoriko-praktik, i ndare ne dy semestre me nga 16 jave secili. Semestri i pare fillon me 1 Tetor 2004 dhe mbaron 10 Shkurt 2005, ndersa semestri i dyte fillon 12 Shkurt 2005 dhe mbaron ne 30 Qershor 2005. Totali i lendeve qe behen ne kete vit eshte 18, nga te cilat 9 lende kryesore jane vjetore dhe 9 lende semestrare. Totali i oreve gjate vitit akademik eshte 1424 ore, te ndara 752 ore semestrin e pare, (47 ore/jave) dhe 672 ore per semestrin e dyte, (42 ore/jave);
- **Vitin e dyte-** te praktikës vëzhguese-pasive, ku kandidatet, per tre dite ne jave ndjekin nga afer punen qe realizohet ne gjykatat dhe prokurorite ku ata kryejne praktiken, si dhe dy ditet e tjera realizojne konkluzionet e praktikës ne shkollë, diskutojne raste te ndryshme, pergatisin gjyqe imituese etj. Gjate ketij viti, kandidatet perballojne nje ngarkese mesimore prej 1650 oresh, nga te cilat 1154 ore praktike ne organet e drejtesise dhe 504 ore ne auditoret e shkolles. Gjate vitit te dyte te shkolles kandidatet duhet te pregatisin edhe nje teme civile ose penale nen udheheqjen e nje drejtuesi te aprovuar nga shkolla;
- **Vitin e trete-** te praktikës aktive, ku kandidatet marrin nje emerim paraprak nga Keshilli i Larte i Drejtesise dhe kryejne stazhin si gjyqtare apo prokurore, fillimisht me ceshtje penale e civile te thjeshta, duke evoluar gradualisht drejt ceshtjeve me te veshtira.

Shkolla e Magjistratures eshte nje vazhdim i arsimit juridik te fituar ne Fakultetet e Drejtesise. Ndonese ajo nuk eshte pjese e sistemit arsimor ne Shqiperi, ne pergatitjen e programeve dhe te planeve mesimore te saj mbeshitet per analogji dhe ne aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne arsimin e larte.

Bazuar ne ligjin Nr.7810, date 06.04.1944 dhe ne Udhezimin Nr.22, date 10.10.1997 "Per organizimin e kurseve te studimit ne shkollat e larta", nxjerre nga Ministri i Arsimit, jane percaktuar elemente te tille si: ora e punes, koha e punes, kohezgjatja e kurseve si edhe lloji i lendeve.

<b>Ora e punes</b> ne Shkollen e Magjistratures	-	60 minuta
Ora e punes e programuar	-	50 minuta
Koha e pushimit	-	10 minuta
<b>Dita e punes</b>	-	8.4 ore
Fillon ne oren 8.00 dhe mbaron ne oren 16.30		
Dita e punes e programuar	-	8.4 ore
Koha e pushimit	-	1 ore

Java e punes ne Shkollen e Magjistratures - 5 dite

Dita e shtune dhe e diele eshte pushim.

**Sasia e oreve te punes se programuar per secilin nga kurset percaktohet ne funksion te :**

- Natyres se kursit,
- Paisjes se mesimdhënies me tekste, leksione te shkruara apo materiale te tjera,
- Bazes materiale qe mbështet kursin, dosje te praktikës gjyqësore, përdorimi i sallës se gjyqit imitues, etj
- Detyrave te pavarura te ngarkuara paraprakisht kandidateve.

Mbështetur ne aktet e mesiperme cdo program mesimor i seciles lende apo kurs permban te pakten 15 ore.

**Menyra e mesimdhënies ne Shkollen e Magjistratures eshte interaktive, e tille qe synon te pakten ne:**

1. trajtimin e elementeve teorike ne formen e ligjeve te reja apo te situatave te reja juridike duke shmangur perseritjet nga njohurite e marra ne Fakultetin e Drejtesise.
2. organizimin e debateve juridike lidhur me dispozita te diskutueshme juridike apo boshlleqe ligjore.
3. diskutim ne cdo ore te tre deri kater raste te nxjerra nga praktika gjyqësore dhe zgjidhjen e tyre nga kandidati;
4. pergatitjen e gjyqeve imituese duke ndare kandidatet ne rolin e aktoreve te procesit si gjyqtare, prokurure, avokate, eksperte, etj;
5. organizimin e takimeve dhe te vizitave prane institucioneve te drejtesise te te gjitha shkalleve si edhe institucioneve te lidhura me to.
6. ngarkimin e studenteve me pergatitjen e punimeve te pavarura lidhur me probleme te mprehta dhe aktuale te praktikës.

Llojet e lendeve qe behen ne shkollen e Magjistratures jane:

**A. Lende vjetore te shtrira gjate gjithë vitit akademik:**

1. **E Drejta Civile, rregjistrimi i pasurive te paluajteshme**, eshte lende vjetore dhe e ndare ne dy semestra ne 16 jave secila, eshte planifikuar te behet 6 ore ne jave, dhe te jepet provim ne fund te vitit.
2. **E Drejta Penale**, eshte lende vjetore dhe e ndare ne dy semestra ne 16 jave secila, eshte planifikuar te behet 6 ore ne jave, dhe te jepet provim ne fund te vitit.
3. **Procedura Civile**, eshte lende vjetore dhe e ndare ne dy semestra ne 16 jave secila, eshte planifikuar te behet 6 ore ne jave, dhe te jepet provim ne fund te vitit. (Per shkak se pedagogu pergjegjes i lendes eshte i porsaemeluar dhe per faktin se aktualisht shkolla po punon ne kuadrin e kredise se Bankes Boterore per te botuar nje liber per te Drejten Procedurale Civile, Bordi ra dakort qe lenda e Procedures Ccivile te zhvillohet ne vitin shkollor 2004-2005 per vitin e pare dhe te dyte )
4. **Procedura Penale**, eshte lende vjetore dhe e ndare ne dy semestra ne 16 jave secila, eshte planifikuar te behet 6 ore ne jave, dhe te jepet provim ne fund te vitit. (Kete vit studentet peer here te pare do te perdorin si material mesimor Komentarin e Procedures Penale te pergatitur nga z.Halim Islami, z.

*Artan Hoxha dhe Z Ilir Panda, te cilet jane edhe pedagoget e kesaj lende neShkollen e Magjistratures).*

5. **E Drejta Tregtare, falimentimi, konkurenca;** eshte lende vjetore dhe e ndare ne dy semestra me 16 jave secili, eshte planifikuar te behet 3 ore ne jave ne semestrin e pare dhe 4 ore ne jave ne semestrin e dyte, dhe te jepet provim ne fund te vitit.
6. **E Drejta Kushtetuese,** eshte lende vjetore dhe e ndare ne dy semestra ne 16 jave secila, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave, dhe te jepet provim ne fund te vitit.
7. **E drejta Komunitare,** eshte lende vjetore, e ndare ne dy semestra me 16 jave secili, eshte planifikuar te behet dy ore ne jave dhe te jepet provim ne fund te vitit,
8. **E drejta administrative dhe prokurimet publike** eshte lende vjetore, e ndare ne dy semestra me 16 jave secili, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave dhe te jepet provim ne fund te vitit.
9. **E Drejta Familjare,** eshte lende vjetore, e ndare ne dy semestra me 16 jave secili, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave dhe te jepet provim ne fund te vitit. *(Bordi ra dakort qe edhe e Drejta Familjare te zhvillohet ne vitin vitin shkollor 2004 – 2005 per vitin e pare dhe te dyte duke ju lene mundesi grupit te pedagoqeve te pergatisin leksionet, pasi sic dihet Kodi i ri i Familjes eshte miratuar se fundi dhe hyn ne fuqi ne muajin dhjetor.)*

---

**Lendet semestrale, ne formen e kurseve:**

10. **Te Drejtat e Njeriut,** eshte lende semestrale, eshte planifikuar te zhvillohet ne semestrin e pare, te behet 2 ore ne jave dhe te jepet provim ne fund te semestrit te pare.
11. **E Drejta e punes,** eshte lende semestrale, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e pare dhe te jepet provim ne fund te semestrit.
12. **Etika Profesionale,** eshte lende semestrale, e planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e pare dhe te jepet provim ne fund te semestrit.
13. **Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor,** eshte lende semestrale, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e pare dhe te jepet provim ne fund te semestrit.
14. **E Drejta Nderkombetare private,** eshte lende semestrale, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e pare dhe te jepet provim ne fund te semestrit. *( Kjo lende per here te pare kete vit do te jepet me librin e ri te pregatitur nga Shkolla ne bashkpunim ne Justice Reform International ne kuadrin e kredise se Bankes Boterore per reformen ne Drejtesi.)*
15. **E Drejta Tatimore e Doganore,** eshte lende semestrale, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e pare dhe te jepet provim ne fund te semestrit.
16. **Pronesia Intelektuale,** eshte lende semestrale, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e dyte dhe te jepet provim ne fund te semestrit. *(Kjo lende per here te pare do te jepet me librin e ri te pregatitur nga Shkolla e*

*Magjistratures ne bashepunim me Justice Reform International ne kuadrin e kredise se Bankes Boterore per Reform ne Drejtesi.)*

17. **Ndermjetesimi dhe Arbitrazhi** eshte nje lende e re, semestrare eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e dyte dhe te jepet provim ne fund te semestrit. *(Kjo lende per here te pare do te jepet me librin e ri te pergatitur nga Shkolla e Magjistratures ne bashepunim me Justice Reform International ne kuadrin e kredise se Bankes Boterore per Reform ne Drejtesi).*
  
18. **Menaxhimi i gjykatave** dhe i rasteve eshte nje lende e re, semestrare, eshte planifikuar te behet 2 ore ne jave ne semestrin e dyte dhe te jepet provim ne fund te semestrit. *(Kjo lende per here te pare do te jepet me librin e ri te pergatitur nga Shkolla e Magjistratures ne bashepunim me Justice Reform International ne kuadrin e kredise se Bankes Boterore per Reform ne Drejtesi).*

**DREJTORE**

**ARIANA FULLANI**

MIRATOHET

Tirane, me 24.09.2003

Kryetari

Thimjo KONDI

**PLANI DHE PROGRAMI MESIMOR PER VITIN E II-TE TE SHKOLLES SE**  
**MAGJISTRATURES**  
**(Periudha e stazhit paraprofessional)**  
**(Viti akademik 2004-2005)**

**Personat pergjegjes:**

- Pedagogu pergjegjes i ndihmuar nga nje gjyqtar ( per studentet kandidate per gjyqtare ) dhe nje prokuror ( per studentet kandidate per prokurore).

**Ngarkesa Mesimore vjetore: 1656 ore mesimore**

Ngarkesa mesimore 1656 ore nga te cilat 1272 ore praktike e drejtesise dhe 384 ore ne auditor per zhvillimin e seminareve praktike ( gjykimet imituese).

Zhvillimi i seminareve praktike ne auditor do te perfshije diskutimin e kazuseve te parapregatitura nga pedagogu pergjegjes apo te pregatitur nga studente ne baze te ceshtjeve qe ndjekin ne praktike, ne diskutimin e te gjitha akteve proceduriale qe duhet te pregatitin gjyqtaret dhe prokuroret, diskutim i cili do te organizohet mbi akte konkrete te pregatitura nga studentet, organizim i gjyqeve imituese ne sallen – maket si dhe kurse te shkurtera teoriko-praktike.

Organizimi i praktikës do te behet prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per studentet kandidate per gjyqtare.Nen kryetarja i Gjykates se rrethit do te jete personi i cili do te organizojne, ne bashkepunim me pedagogun pergjegjes, menyren e realizimit te praktikës perfshire qarkullimin ne sektore te ndryshem te institucioneve, frekuentimin, kontaktet individuale me gjyqtare e prokurore etj.

Ngarkesa mesimore javore do te jete si me poshte:

Praktika mesimore ne Gjykate do te zhvillohet te Marte, te Merkure, te Enjte nga ora 8<sup>00</sup> deri ne oren 15<sup>00</sup>

Diten e Hene e te Premte ne Shkolle nga Ora 8<sup>30</sup> – 15<sup>30</sup>

Viti akademik i ndare ne dy semestra:

Sem. I – re 16 jave ( 1 Tetor 2002 – 31 Janar 2004 )

Sem.II – te 16 jave ( 1Shkurt 2003- 31 Maj 2004 )

Detyrimet e tjera vjetore:

Kandidatet gjate kohes se praktikës do te punojne nje teme teorike te mbeshtetur ne materialet arkivore te Gjykates dhe te Prokurorise si dhe literature e autoreve vendas dhe te huaj. Perzgjedhja e temave do te behet nga Drejtoria e shkolles dhe Keshilli Pedagogjik pasi te jete marre me pare edhe sugjerimi i studenteve.

Tema do te dorezohet ne fund te muajit Prill 2004

## **1. Qellimi i programit:**

### **Per kandidatet gjyqtar:**

- Dhenia e shprehive praktike kandidateve per punen e gjyqtarit qe do te realizohet nepermjet:
  - a. njohja me proceduren e pranimit te kerkese padive ne gjykate dhe provave qe i bashkangjiten asaj, proceduren e hedhjes se shortit, rregjistrimin e padise si dhe pergatitjen e dosjes.
  - b. Njohja me elementet praktik te procedures se gjykimit.
  - c. Pergatitja e kandidatit per drejtimin e seances gjyqesore, marrjen e provave ne gjykim, vendimeve te ndermjeteme dhe dhenien e vendimit perfundimtar apo jo perfundimtar.
  - d. Studimi i vendimeve gjyqesore per te fituar shprehite e pergatitjes se tij ne menyre ligjore, llogjike dhe argumentuese.
  - e. Pergatitja e gjykimeve imituese ne Shkollen e Magjistratures nga kandidatet.
  - f. Njohja me gjykimet ne te gjitha kolegjet ( seksionet ) ne gjykate.
  - g. Njohja me funksionimin e sektoreve ndihmes se gjykates.
  - h. Njohja me proceduren e gjykimit ne gjykatën e Apelit dhe gjykatën e Larte si dhe kufijte e shqyrtimit te ceshtjes ne keto gjykata.
  - i. Njohja me gjykimet per masat e sigurimit dhe disponimet e tjera qe lidhen me te drejtat dhe lirite themelore te njeriut si kontrolli i baneses, pergjimi etj.
  - j. Njohja e procedures se ekzekutimit te vendimeve penale nga prokurori.
  - k. Pjesmarrja ne Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Larte per te njohur nga afer rolin e prokurorit perpara ketyre gjykatave.

### **Program i pershtatshem per kandidatet gjyqtare dhe prokurore:**

1. Njohja e veprimtarise praktike te punes ne sektore te tjere ndihmes te lidhur me punen e gjykates dhe te prokurorise.
  - Njohja e veprimtarise praktike te zyres se rregjistrimit tregtar ne Gjykatën e Tiranës.
  - Njohja e punes se avokateve prane zyrave te avokatise.
  - Njohja e veprimeve noteriale prane zyrave noteriale.
  - Njohja e procedurave te rregjistrimit te pasurive te paluajteshme ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajteshme ne Tirane.
  - Njohja e punes se nje qendre ndermjetesimi dhe arbitrazhi.
  - Njohja e procedures e nxjerrjes se akteve administrative nga administrata shteterore, qendrore dhe lokale.
  - Njohja me proceduren e ekzekutimit te vendimeve penale ne kampe e burgje.
  - Njohjen e procedures se ekzekutimit te vendimeve civile dhe titujve te tjera ekzekutiv nga zyra e permbarimit.
  - Njohjen e procedures se marrjes se denoncimeve dhe veprimeve per kqyrjen e vendit te ngjarjes nga oficeret e policise gjyqesore ne komisariatet e policise.
2. Njohjen e veprimtarise ne Gjykatën Kushtetuese duke marre pjese ne seancat e zhvillimit te ketyre gjykimeve.

3. Njohja e organizimit te punes ne Prokurorine e Pergjithshme dhe veprimtarise praktike ligjore te kryer prej saj.

### **Rruget e arritjes se qellimit**

1. Ndjekja nga afer e procesit te hetimit dhe te gjykimit te ceshtjeve civile dhe penale si dhe te punes te administrates gjyqesore dhe policise gjyqesore.
2. Studimi i organizuar i dosjeve gjyqesore dhe trainimi i tyre ne seanca workshop-esh ne shkolle (praktika ne gjykate do te behet tre dite ne jave dhe dy dite te tjera me workshop-esh ne shkolle ).
3. Pergatitja e nje teme praktike ne fushen civile ose penale qe synon ne nxitjen e inisiatives se studenteve per t u marre me veprimtari shkencore si dhe ndihmen e tyre per njohjen e te interesuarve me unifikimin e praktikës gjyqesore per nje periudhe te caktuar kohe.
4. Pergatitja e gjyqeve imitues duke shfrytezuar praktiken gjyqesore ne fushen penale dhe civile (jo me pak se 2 gjyqe imituese civile dhe penale.
5. Vizita ne Zyra dhe Institucione te tjera juridike qe lidhen direkt ose indirekt me punen e gjykatesit dhe te prokurorit.
  - Ne zyrat e rregjistrimit tregtar
  - Ne zyrat avokatore
  - Ne zyrat noteriale
  - Ne zyren e rregjistrimit te pasurive te paluajtshme
  - Ne Gjykatën e Apelit
  - Ne Gjykatën e Larte
  - Ne Gjykatën kushtetuese
  - Ne Prokurorine e Pergjithshme
  - Ne kampe e burgje
  - Ne nje qender ndermjetesimi dhe arbitrazhi.
  - Ne zyren e permbarimit te Tiranes
  - Ne Komisaritet e policise
  - Avokati i Popullit

### **6. Plani i kurseve teoriko-praktike qe do te ndiqen cdo muaj**

Temat teorike qe do te trajtohen ne vitin e dyte ne formen e ciklit te leksioneve dote jene:

E Drejta Urbane, Drejtesia dhe Media, korrupsioni dhe lufta kunder tij, E drejta e Ambjentit, Ligji i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave, Kodi Elektorale, Kriminalistike, Kriminallogji, Perspektiva gjinore dhe dhuna ne familje, E Drejta e Refugjateve, Shteti Ligjor dhe Shteti i se Drejtes, Psikologji, Metodike Hetimi etj.

Drejtore

---

**Ariana Fullani**



1. Plani i kurseve teoriko - praktike qe do te ndiqen cdo muaj 2004 - 2005

Nr	Emertimi i lendes	Gjithsej/ore	Sem.I-re	Sem.II-te
1	Avokati i Popullit	16	16 ore	-
2	Rregjistrimi i pasurive	16	16 ore	-
3	E Drejta e Sigurimeve te pasurise dhe te prones	16	16 ore	-
4	Kriminalistike	16	16 ore	-
5	Kriminalogji	16	16 ore	-
6	E Drejta Familjare	64	2 ore/jave	2 ore/jave
7	Procedura Civile	192	4/2 ore/jave	4/2 ore/jave
8	Trafikimi	16	-	16 ore
9	Dhuna ne familje	16	-	16 ore
10	Perkatesia gjinore	16	-	16 ore
	<b>Shuma e oreve</b>	<b>384 ore</b>	<b>194 ore</b>	<b>190 ore</b>

